

Nr. Prot. 046/B/19

VENDIM Nr. 1376

Për

Miratimin e dokumentit

“Plani për Hapjen e Brezeve me vlerë të posaqme ekonomike ”

Në mbështetje të nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.6), nenit 10, paragrafi 4) dhe 12), nenit 45 paragrafët 1) dhe paragrafi 2), nenit 54 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 4), dhe nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi, | Kryetar |
| 2) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari, | Anëtar |
| 4) z. Bahri Anadolli, | Anëtar |
| 5) z. Shqiprim Pula | Anëtar |

në mbledhjen e 39-të me radhë të mbajtur më datë 07 Maj, 2019 pas shqyrtimit të Rekomandimit të Komisionit sipas Vendimit Nr.1247 (*Ref. Nr.Prot. 047/B/19*), vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet dokumenti: **“Plani për hapjen e brezeve me vlerë të posaqme ekonomike”**.
- II. Miratohet dokumenti: **“Konkluzione nga këshillimi publik i dokumentit – Plani për hapjen e brezeve”**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Gjatë periudhës së Konsultimit Publik, komente kanë dërguar operatorët si në vijim: Telekom i Kosovës sh.a. (nr. prot. 576/2/18; dt. 01.08.2018), IPKO Telecommunications LLC (nr. prot.572/2/18;

dt. 01.08.2019), Dardafon.Net_ (nr. prot.575/2/18 dt. 01.08.2019) dhe "mts" D.O.O. (Ref. ARKEP Nr.Prot. 557/2/18; dt. 25.07.2018).

ARKEP ka analizuar komentet e pranuar nga operatorët si dhe një numër të konsiderueshëm të akteve si: Direktivave, Vendimeve, Rekomandimeve, Raporteve të Bashkimit Evropian (BE), CEPT dhe BEREC-ut lidhur me brezet frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT.

Dokumenti "Plani për Hapjen e Brezeve" përshkruan në mënyrë të detajuar Kornizën rregullatore në Republikën e Kosovës dhe Bashkimin Evropian (BE) lidhur me brezet frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT, kapacitetet frekuencore të disponueshme në Republikën e Kosovës për secilin brez së bashku me kërkesat e operatorëve për brez, pasqyrën e tregut të komunikimeve elektronike me fokus në tregun e telefonisë mobile, periudha dhe fazat për hapjen e brezeve për shërbimet IMT, ku janë specifikuar edhe objektivat rregullatore, përkatësisht ndikimi i tyre në përcaktimin e vlerës së spektrit, si dhe janë përfshirë 3 shtojca.

Ligji, respektivisht neni 10 paragrafi 12 (Kompetencat e Autoritetit) përkufizon kompetencat e Autoritetit për menaxhimin e resurseve dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 45, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se: "Spektri frekuencor (kanalet) do të menaxhohet duke u bazuar në Planin Kombëtar të Radio – frekuencave dhe Planin për përdorimin e radio – frekuencave (kanaleve) konform planeve zhvillimore për radio komunikime."

Neni 54, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se ARKEP vendos kushtet për shfrytëzimin e radio-frekuencave.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 08/05/2019

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
- Komisionit të Pavarur për Media,
- Ndërmarrjeve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike

- Arkivës së Autoritetit.